



Data: 01.10.19 Ref.: 1886/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 78-të, të mbajtur më 27.09.2019, mori:

V E N D I M

- I. Validohen programet e studimit të Kolegjit Riinvest për periudhë 1 Tetor 2019 – 30 Shtator 2024
 - Ekonomiksi dhe Politika, BSc 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Shkenca e të dhënave dhe Analiza e Biznesit, BSc 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

I. Kolegji Riinvest ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara, rreth akreditimit dhe validimit të këtyre programeve në University of London. Ky institucion është akredituar nga British Accreditation Council, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Riinvest
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.